




Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Elez Han

02/9009/2013

Data:	03.07.2013
PËR :	Departamenti Ligjor i MAPL-së z. Agron Maxhuni
PËRMES:	Kryetari i Komunës Rufki Suma
NGA :	Shefi i Zyrës Ligjore Bajrush Laçi
LËNDA:	Vendimet e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit për muajin QERSHOR

I nderuar z.Maxhuni;

Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me nr. 03/L-040, përkatësisht neni 80 nënparagrafi 80.1, dërgojmë për shqyrtim të rregullt këto vendime të Kuvendit të Komunës siç vijojnë:

1. Vendim për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2014 – 2016, vendimi me numër 01 Nr.3472-2013
2. Vendim për miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve në komunën e Hanit të Elezit vendimi me numër 01.Nr.3442-2013
3. Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave, vendimi me numër 01.Nr.3444 - 2013
4. Vendim për caktimin e tarifës për leje ndërtimore dhe infrastrukturë, me numër 01.Nr.3443-2013
5. Vendim për miratimin e Rregullorës për ndarjen e subvencioneve me numër 01.Nr.2223/2013
6. Vendim për miratimin e Statutit të Qendrës për Punë Sociale, me numër 01.Nr.2874-2013
7. Vendim për miratimin e propozimit për caktimin e kritereve për priorizimin e investimeve kapitale në komunën e Hanit të Elzit, me numër 01.Nr.3474 - 2013
8. Vendim për miratimin e pëlqimit për kompaninë “ARSI” sh.p.k për hulumtime gjeologjike me shpim, vendimi me numër 01.Nr.3381-2013

Të bashkangjitur gjeni, Rregullorën për Subvencione dhe Statutin e Qendrës për punë sociale

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/Nr.3472/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokalen Nr.03/L-40 neni 11, 40, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit Nr.03/L-48 neni 20, Qarkorja Buxhetore 2014/01 për Komuna, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE 2014-2016

I

Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2014-2016 me numër 04/Nr.3472/2013 e datës 04.06.2013 e cila përmban planifikimet nga financimet qeveritare dhe nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2014-2016, planifikimi i buxhetit për vitin 2014 është në shumë prej 1,874,695 €, parashikimi i buxhetit për vitin 2015 është në shumë prej 1,924,931 €, parashikimi i buxhetit për vitin 2016 është në shumë prej 1,964,679 €.

II

Korniza afatmesme buxhetore për vitet 2014-2016 përmban qëllimin, objektivat parashikimet për vitet vijuese dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/ Nr.3442 /2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 17 shkronja (o), 40, Statutin e Komunës neni 6 shkronja (p), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

I

Miratohet propozim vendimi me numër 06/Nr.3442/2013 i datës 03.06.2013 për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve në Han të Elezit.

II

Komisioni për emërtimin e rrugëve përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve 3 nga kuvendi i komunës, 3 (tre) nga Ekzekutivi dhe 1 (një) Administratorë i fshatit përkatës. Komisioni ka këtë përbërje: Mefail Suma, Sali Vila , Menduh Vlasi, Kujtim Dernjani, Durim Dernjani, Drejtori për Urbanizë, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Administratori i Fshatit.

III

Për emërtimin i rrugëve komisioni do të vendos kritere, të cilat janë të parapara edhe në Ligjin e sistemit të adresave nr.04/L-071 dhe akteve të tjera juridike në fuqi.

IV

Pas kryerjes së punës nga ana e këtij komisioni vendimi për emërtimin e rrugëve do të miratohet në Kuvendin e Komunës.

V

Komisioni do të bashkëpunoj me zyrën për Urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të ambientit, në mënyrë që të marrë të gjitha format digjitale të rrugëve në mënyrë që procesi të jetë i saktë.

VI

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/ Nr.3444 /2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 17, 40, Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 neni 4, Statutin e Komunës neni 6, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHË TË PARCELAVE

Miratohet propozim vendimi me numër 06/Nr.3444/2013 i datës 03.06.2013 për shpalljen me interes të përgjithshëm për komunën e Hanit të Elezit të gjitha parcelat e poshtë shënuara.

Parcelat Kadastrale me nr.92-7,92-9,93-6,300-2,300-4,320-3,320-4,320-6,320-8,320-9,332-2,335-2, 348-2,349-8 Zona Kadastrale Hani i Elezit të evidentuara në çertifikatën e pronësisë nr. UL-73317036-00006 dhe parc.kad nr.567-0 zona kadastrale Dërmjak të evidentuara në çertifikatën e pronësisë nr.UL-73317037-00033, në emër të P.SH. FABRIKA E ÇIMENTOS"SHARR" nga Hani i Elezit.

- a) Nr. 92-7, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë gurishte e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur "Xehrorja e Llaporit", me sipërfaqe prej 00 01 60 ha, e evidentuar në çertifikatë e pronësisë nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- b) Nr. 92-9, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë Gurishte e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur "Xehrorja e Llaporit", me sipërfaqe prej 00 02 50 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- c) Nr. 93-6, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë rrugë e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur "Xehrorja e Llaporit", me sipërfaqe prej 00 12 89 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- d) Nr. 300-2, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë rrugë e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur "Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 55 00 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- e) Nr. 300-4, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë rrugë e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos ", me sipërfaqe prej 00 16 87 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- f) Nr. 320-3, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë jo pjellore e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos ", me sipërfaqe prej 00 24 19 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.

- g) Nr.320-4, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë oborr i klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos ", me sipërfaqe prej 00 04 47 ha, e evidentuar në çertifikate pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- h) Nr.320-6, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë oborr i klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos ", me sipërfaqe prej 00 03 56 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- i) Nr. 320-8, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë oborr e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos ", me sipërfaqe prej 00 14 13 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit
- j) Nr. 320-9, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë oborr i klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos ", me sipërfaqe prej 00 00 70 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- k) Nr. 332-2, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë kullosë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 13 49 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- l) Nr. 335-2, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë jo pjellore e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur " Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 03 46 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- m) Nr. 348-2, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë kullosë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Draça", me sipërfaqe prej 00 04 27 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- n) Nr. 349-8, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë kullosë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Draça", me sipërfaqe prej 00 02 85 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- o) Nr. 352-1, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 07 25 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- p) Nr. 351-2, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Draça", me sipërfaqe prej 00 02 87 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- q) Nr. 351-3, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Draça", me sipërfaqe prej 00 00 60 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- r) Nr. 353-1, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 02 38 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- s) Nr. 354-1, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 07 69 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- t) Nr. 355-1, pronë shoqërore, zonë Urbane,me kulturë livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 08 36 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.

- u) Nr. 356-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë mal i klasit 4 (Katër), në vendin e quajtur "Fabrika e Çimentos", me sipërfaqe prej 00 04 75 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- v) Nr. 567-0 pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë gurishte e klasit 0 (zero), në vendin e quajtur Llashtica", me sipërfaqe prej 00 69 43 ,e e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317034-00033 zona Kadastrale Dërmjak.

Parcelat Kadastrale me nr.293-1,293-2,294-0,295-0,357-0,358-0,359-0, Zona Kadastrale Hani i Elezit të evidentuara në çertifikatën e pronësisë nr.UL-73317036-00010, emër të P.SH. INDUSTRIA KIMIKE – ORGANIKE”KOSOVAPLAST” Zagreb.

- a) Nr. 293-1, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Draça", me sipërfaqe prej 00 05 79 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- b) Nr. 293-2, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Draça", me sipërfaqe prej 00 00 60 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- c) Nr. 294-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana", me sipërfaqe prej 00 08 37 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- d) Nr. 295-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana ", me sipërfaqe prej 00 15 20 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit.
- e) Nr. 357-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana ", " ", me sipërfaqe prej 00 06 70 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit
- f) Nr. 358-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë e klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana ", me sipërfaqe prej 00 20 20 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit
- g) Nr. 359-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Arë i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana ", me sipërfaqe prej 00 26 47 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit
- h) Nr. 361-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana ", me sipërfaqe prej 00 07 01 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit
- i) Nr. 363-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Livadh i klasit 5 (pesë), në vendin e quajtur "Matana ", me sipërfaqe prej 00 13 53 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit
- j) Nr. 395-0, pronë shoqërore, zonë Urbane, me kulturë Livadh i klasit 5 (Pesë), në vendin e quajtur "Matana ", me sipërfaqe prej 00 15 39 ha, e evidentuar në çertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00010, Zona Kadastrale Hani i Elezit

ARSYETIM

Për parcelat me nr.92-7,92-9,93-6 janë parcela ku tani shfrytëzohen si rrugë dhe atë rruga e quajtur "Isen Suma" e cila rrugë shpie për në fshatin Dimcë dhe dy rrugica të tjera .

Për parcelën me nr.300-2 kjo parcelë tani shfrytëzohen si rrugë dhe atë rruga e quajtur "Dëshmorët e Krivenikut" " rrugë e cila lidhë fshatrat, Krivenik, Gorancë, Rezhancë dhe Gllloboqicë.

Për parcelën me nr.300-4, kjo parcelë ku tani shfrytëzohen si rrugë për te fusha e futbollit dhe atë "Suad Brava".

Për parcelën me nr.320-3 një pjesë e kësaj parcele ,është pjesë e rrugës"Dëshmorët e Krivenikut"ndërsa pjesa tjetër ,është e shfrytëzuar si lokacion ,ku janë të ndërtuara disa lokale të cilave Komuna , më herët ju ka ndarë lokacione dhe leje për shfrytëzim familjeve të Dëshmorëve.

Për parcelat me nr.320-4,320-8,320-9, këto parcela tani shfrytëzohen si pjesë të gjelbëruara jashtë rrethojave të fabrikës "Sharrc-em " sh.p.k Hani i Elezit, për gjatë rrugës " Adem Jashari"-Magjistrales Prishtinë-Shkup.

Për parcelën me nr.320-6, kjo parcelë tani shfrytëzohen si oborr para shtëpisë kulturës "Imri Curi" Hani i Elezit.

Për parcelat me nr.332-2,335-2,348-2,349-8, këto parcela tani e përbëjnë rrugën " Eksoti -99", që shfrytëzohet nga banorët –familjet Vlashi dhe Luri nga Hani i Elezit.

Për parcelën me nr.567-0, në këtë parcelë janë të ndërtuar 24 rezervar të ujit dhe ndërtesa ku bëhet filtrimi i ujit të pijshëm, me të cilin furnizohet Hani i Elezit.

Për parcelat me nr.352-1,351-2,351-3,353-1,354-1,355-1,356-0, këto parcela tani shfrytëzohen si rrugë, pra bëhet zgjerimi i këtyre rrugëve përgjatë Hekurudhave.

Siç po shihet me lart të gjitha këto parcela që i kërkojmë që t'i bartim në posedim , janë sipërfaqe të domosdoshme, pra që shfrytëzohen kryesisht për rrugë , gjelbërim dhe furnizim me ujë të pijshëm.

Për parcelat me lartë cekura nr.293-1,293-2,294-0,295-0,357-0,358-0,359-0,361-0,363-0,395-0, në këto parcela është vendosur fusha futbollit "Suad Brava ", andaj pasi që kemi të vetmen hapësirë mjaftueshme për këtë fushë futbollit, pasi që në Zonën Kadastrale Hani i Elezit nuk kemi hapësirë të mjaftueshme për hapësira për aktivitete sportive.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/ Nr.3443 /2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Ndërtim nr.04/L-110, neni 22, 23 dhe Udhëzimit Administrativ nr.22/2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E TARIFËS PËR LEJE NDËRTIMORE DHE INFRASTRUKTUR

I

Miratohet propozim vendimi me numër 06/Nr.3443/2013 i datës 03.06.2013 për caktimin e tarifës për leje ndërtimore dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës.

II

Sipas nenit I të këtij vendimi tarifa për leje ndërtimore caktohet 3.03 €/m², ndërsa tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës për kokë banori caktohet 96.72€.

III

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/ Nr.2223 /2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 40, Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike neni 43 paragrafi 3 si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Hanit të Elezit neni 15 shkronja (a), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

I

Miratohet rregullorja me numër 02/Nr.2223/2013 me tekstin e mëtejshëm Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore, rregullorja ka për qëllim që të përcakton kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës –fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale personave fizik dhe juridik.

III

Rregullorja përmban 22 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.2874 /2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 17 shkronja (k) 40, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.02L-17 neni 6 ,7, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 6 shkronja (l), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

I

Miratohet Statuti me numër 02/Nr.2874/2013 me tekstin e mëtejshëm Statuti i Qendrës për Punë Sociale .

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore, me këtë Statut rregullohet emërtimi dhe selia, veprimtaria, statuti juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Qendrës, udhëheqja dhe trupat e Qendrës.

III

Statuti i Qendrës për Punë Sociale përmban 38 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.3474/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokalen Nr.03/L-40 neni 11, 17, 40, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 6, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 mori:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR ÇAKTIMIN E KRITEREVE PËR PRIORITIZIMIN E INVESTIMEVE KAPITALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

I

Miratohet propozimi me numër 04/Nr.3474/2013 për caktimin e kriterëve për prioritizimin e investimeve kapitale në komunën e Hanit të Elezit.

II

Caktimi i kriterëve për prioritizimin e investimeve kapitale në komunën e Hanit të Elezit përmban qasjen e propozuar, kriteret që duhet të përdoren, Hapi 1 – Plani Zhvillimor Komunal, Hapi 2 - Korniza Afatmesme buxhetore , Hapi 3- Politikat dhe prioritete komunale, Hapi 4 -Shkalla e arkëtimit të tatimit në pronë brenda një fushe specifike në komunë.

III

Duke iu referuar nenit II të këtij vendimi caktimi i kriterëve për prioritizimin e investimeve kapitale në komunën e Hanit të Elezit është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Mënduh Vlasi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT

PROPOZIMI PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR PRIORITIZIMIN E INVESTIMEVE
KAPITALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

TABELA E PËRMBAJTJES

Qasja e propozuar.....	3
Kriteret që duhet të përdoren – ALGORITMI I REZULTATIT.....	3
HAPI 1 – Plani Zhvillimor Komunal (PZHK).....	3
VENDIMET/ ALGORITMI	3
HAPI 2 – Korniza Afatmesme Buxhetore (Korniza afatmesme e shpenzimeve).....	4
VENDIMET / ALGORITMI.....	4
HAPI 3 – Politikat dhe prioritetet komunale (përfshirë prioritetet sektoriale).....	4
VENDIMET / ALGORITMET	5
HAPI 4 – Shkalla e arkëtimit të Tatimit në Pronë brenda një fushe specifike në komunë.....	5
VENDIM / ALGORITMI	5

Qasja e propozuar

Metoda e propozuar për prioritizimin e investimeve kapitale merr parasysh një qasje algoritmike, ku do të ketë disa faktorë të analizuar kur shikohet tek projektet e propozuara. Këto kriteret do të jenë baza e dy vendimeve në këtë proces:

- a) Nëse janë përmbushur kriteret – atëherë ofroni rezultatin
- b) Nëse NUK janë përmbushur kriteret – atëherë diskualifikoni projektin
- c) Në rast se ka më pak projekte sesa sasia e buxhetit, atëherë zgjidhni një projekt nga e Plani Zhvillimor Komunal, por me kushtëzime për shkallën e arkëtimit të tatimit në pronë (Nuk kërkohet pjesëmarrja e qytetarëve në kostot e projektit).

Kriteret që duhet të përdoren – ALGORITMI PËR REZULTATIN

Është propozuar procesi gjenerik si në vijim, i cila duhet të konsultohen dhe të rregullohet bazuar në informata, së bashku me komunat partnere. Duhet të ketë së paku një kriter të zgjedhur nga secila komunë partnere në këtë proces.

HAPI 1 – Plani Zhvillimor Komunal (PZHK)

Për të gjitha projektet e propozuara, Komuna duhet së pari të shikoj nëse projekti është i përfshirë në seksionin e PZHK-së ku janë paraqitur QËLLIMET AFATGJATA TË ZHVILLIMIT KOMUNAL. Ky seksion thekson qëllimet afatgjata në të gjitha fushat me interes në komunë dhe pastaj liston prioritetet strategjike dhe projektet zhvillimore në të gjitha fushat tematike.

Secili projekt i propozuar duhet të përmbaj së paku një referencë nga kjo pjesë e PZHK-së dhe së paku një nga fushat si në vijim, përfshi edhe referencë e qëllimit nga PZHK-ja:

- 1) Fushat Tematike
- 2) Referojuni qëllimit afatgjatë zhvillimor
- 3) Referojuni prioritetit strategjik

VENDIMET/ ALGORITMI

- **Nëse projekti NUK është i përfshirë në asnjë mënyrë në Planin Zhvillimor Komunal, atëherë pushoni çfarëdo konsiderate për projektin dhe diskualifikoni projektin për atë vit.**
- **Nëse projekti ËSHTË i përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal, atëherë:**
 - Përfshijeni në listën e projekteve të mundshme
 - Referojuni strategjisë së veçantë në PZHK dhe përcaktoni fushën tematike/sectorin
 - Shënoni projektin duke u bazuar në listën prioritare që gjendet në tabelën e ndarë të Strategjive, përmes sistemit të mëposhtme:
 - Për projektet që u është dhënë **PRIORITETI 1 – shënoni 3 pikë**
 - Për projektet që u është dhënë **PRIORITETI 2 – shënoni 2 pikë**
 - Për projektet që u është dhënë **PRIORITETI 3 – shënoni 1 pikë**

HAPI 2 – Korniza Afatmesme Buxhetore (Korniza afatmesme e shpenzimeve)

Hapi tjetër është për të verifikuar nëse projekti kualifikohet brenda kriterëve që tashmë janë përfshirë në Kornizën buxhetore Komunale afatmesme / apo në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH).

VENDIMET / ALGORITMI

- Nëse projekti **NUK** është në listën e projekteve me prioritet (investimet kapitale) në Kornizën Buxhetore Komunale Afatmesme, atëherë **SHËNONI 1**.
- Nëse projekti **ËSHTË** në listën e projekteve me prioritet (investimet kapitale) në Kornizën Buxhetore Komunale Afatmesme, atëherë **SHËNONI 2**.
- Nëse projekti është në listën e projekteve me prioritet (Investimet kapitale) dhe ka filluar me realizim në Kornizën Buxhetore Komunale Afatmesme, atëherë **SHËNONI 3**.

HAPI 3 – Politikat dhe prioritetet komunale (përfshirë prioritetet sektoriale)

Për të siguruar politika strategjike bazuar në procesin e buxhetimit të përgjegjshëm, duhet të kërkohet nga kryetari i secilës komunë të deklarojnë prioritetet dhe politikat strategjike në lidhje me sektorët dhe objektivat specifike dhe aktivitetet brenda një sektori, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal - këto prioritete dhe politika duhet të deklarohen publikisht në fillim të çdo viti, më së largu para fillimit të ciklit të Buxhetit të çdo viti për një periudhë tre vjeçare.

Të gjitha projektet e paraqitura për vlerësim dhe përzgjedhje duhet të bazohen në prioritetet e përcaktuara strategjike, sektorët e përzgjedhur duhet t'i përgjigjen objektiveve specifike të deklaruara publikisht.

VENDIMET / ALGORITMET

Nëse projektet e propozuara bien brenda prioritetëve/politikave të deklaruara, atëherë rezultati duhet të jetë si në vijim:

- **Projekti NUK** bie brenda fushëveprimit të fushave me prioritet – **REZULTATI 1**.
- **Projekti bie** brenda fushëveprimit të fushave me prioritet – **REZULTATI 2**.
- **Projekti bie** brenda fushëveprimit të fushave me prioritet dhe është i lidhur drejtpërsëdrejti me objektivat dhe aktivitetet e deklaruara – **REZULTATI 3**.

HAPI 4 – Shkalla e arkëtimit të Tatimit në Pronë brenda një fushe specifike në komunë

Kriteret e prioritizimit duhet të përqendrohen në shkallën e mbledhjes së tatimit në pronë. Qëllimi është që të stimulohet pagesa e tatimit në pronë nga qytetarët, duke kombinuar qasjen karota apo shkopi. Komponenti Karota ka të bëjë me ndryshimin në politikën e komunave, ku Komuna dhe Kryetari i Komunës duhet të deklarojnë publikisht se ata nuk presin nga qytetarët që të kontribuojnë në çdo nivel përkundrejt kostove të projekteve të investimeve kapitale. Megjithatë, secila komunë, në varësi të specifikave të saj, duhet të përcaktojë një nivel minimal të mbledhjes së tatimit në pronë për vitin e kaluar dhe atë aktual financiar (deri në fund të qershorit të vitit aktual). Shkalla e arkëtimit do të matet për zonën komunale (zonë, vendbanim apo rrugë) që është prekur direkt nga projekti i investimit kapital. Nëse një projekt nuk kalon sipas këtyre kriterëve, kryetari i komunës duhet të bëjë një propozim me arsyetim për futjen në listën e projekteve prioritare.

VENDIME / ALGORITME

Sistemi i shënimit dhe vendimmarrjes në Hapin 4 duhet të ndjek hapat e prezantuar:

- a) Përcaktoni zonën gjeografike të komunës që do të preket nga realizimi i projektit.
- b) Analizoni mesataren komunale të shkallës së arkëtimit të tatimit në pronë (për tërë komunën) si dhe për zonat e veçanta për intervenim – për financat e plota të vitit paraprak si dhe për vitin vijues.
- c) Vendosni pragun e shkallës së arkëtimit të tatimit në pronë, bazuar në mesataren komunale të mbledhjes së tatimit në pronë, si dhe në përvojën e kaluar të regjistruar lidhur me shkallën e arkëtimit.
- d) Kryeni analiza softuerike (me bazë në Excel si mjet) për shkallën e arkëtimit, në nivel të rrugës në secilën komunë.
- e) Vetëm projektet që mbulojnë një zonë ku shkalla minimale e arkëtimit për vitin e kaluar, si dhe viti aktual është mbi një përqindje të caktuar (kjo do të ndryshojnë mes komunave), por një shkallë minimale 50% e mbledhjes së tatimit në pronë të vitit të kaluar dhe tatimet në pronë të vitit aktual (rreth 40%) duhet të arkëtohet. Kjo gjithashtu do të mbajë shkallën e borxhit të tatimit në pronë në një nivel të qëndrueshëm dhe të lejojë menaxhimin e rrezikut dhe mos-rritjen e borxhit të tatimit në pronë ndaj komunës.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/Nr.3381/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Statutin e Komunës neni 79, shkresën përcjellëse të datës 19.06.2013 nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit të datës 19.06.2013. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2013 mori:

VENDIM

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KOMPANIN „ARSI” SH.P.K PËR HULUMTIME GJEOLGJIKE ME SHPIM

I

I jepet në parim pëlqimi kompanisë „Arsi” sh.p.k për hulumtime gjeologjike me shpim për shfrytëzimin e parcelave me numër Nr.766-0 me kulturë mal i klasit të shtatë me një sipërfaqe prej 45 19 21 ha, parcela kadastrale me numër 768-0 me kulturë kullosë e klasit të gjashtë në sipërfaqe prej 5 27 93 ha, parcela kadastrale me numër 769-0 me kulturë kullosë e klasit të gjashtë në sipërfaqe prej 081 65 ha e evidentuar në çertifikatën e pronësisë Nr.60 në vendin e quajtur Arat e Gjata pronë shoqërore e ekonomisë pyjore zona kadastrale Krivenik.

II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka plan rregullativ hapësinor, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e ekonomisë pyjore.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës

IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

R R E G U L L O R E
P Ë R
NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Hani i Elezit, 2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 40, Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike neni 43 paragrafi 3 si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Hanit të Elezit neni 15 shkronja (a), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2013 miratoi:

**R R E G U L L O R E N
P Ë R
N D A R J E N E S U B V E N C I O N E V E**

I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

Qëllimi

Neni 1

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedura e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për ndihme momentale, personave fizik dhe juridik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual, kryetari i komunës, sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndan mjete financiare buxhetore - ndihme momentale, për personat juridik dhe fizikë sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 2

Ndihmë momentale sipas kësaj rregullore konsiderohet ndihmë e menjëhershme në para të gatshme që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me vendim të kryetarit të komunës.

Ndihme momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurës)

Neni 3

Ndihma momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurës) përfshinë mbështetjen që u jepet institucioneve kulturore, sportive dhe jo qeveritare.

Neni 4

1. Kërkesat e personave juridik për subvencione duhet t'i drejtohen kryetarit të komunës përmes zyrës së shërbimit të qytetarëve. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacionin mbështetës si:
 - 4.1 Certifikatën e regjistrimit,
 - 4.2 Certifikatën e numrit fiskal
 - 4.3 Arsyetimi i kërkesës me provë të qartë dhe bindëse
 - 4.4 Numri i llogarisë bankare të entitetit publik si dhe
 - 4.5 Letërnjoftimin e bartësit të kartelës

Neni 5

Kryetari i komunës pas pranimit të kërkesës, e autorizon drejtorinë përkatëse, të jep mendim profesional për përfituesit. Propozimi i dërgohet për aprovim kryetarit të komunës. Kryetari i aprovon kërkesat e justifikuar dhe të dëshmuara me dokumentacionin përcjellës.

Neni 6

Kryetari i komunës, merr vendim lidhur me kërkesën e entitetit publik, deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore. Nëse ndihma financiare ka të bëjë me shumë më të madhe, ajo procedohet në Komitetin për Politikë dhe Financa respektivisht në Kuvendin e Komunës për miratim.

Kriteret për financimin e projekteve nga subvencionimi.

Neni 7

7.1 Projektet nga fusha e kulturës:

7.1.1 Promovimet e vlerave (festivalet, koncertet, shënimet e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozita dhe promovimi i librave të botuara);

7.1.2. Veprimtaria botuese;

7.1.3. Veprimtaria teatrale;

7.1.4. Veprimtaria filmike;

7.1.5. Artet pamore;

7.1.6. Trashëgimia kulturore;

7.1.7. Grupet Artistike të Hanit të Elezit.

7.2.1 Projektet për çështje gjinore dhe integritet socio - kulturore.

7.2.2 Projekti duhet të ketë vlera krijuese artistike;

7.2.3 Shumat e mjeteve caktohen sipas strukturës komplekse të projektit (promovimet);

7.2.4 Mbështetja e botimeve bëhet kryesisht për shpenzimet e shtypit;

7.2.5 Vlerësimi i veprimtarisë teatrale bëhet në bazë të kalkulimit të shpenzimeve të shfaqjeve teatrale;

7.2.6 Veprimtaria filmike vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve të kalkuluar sipas zhanrit dhe skenarit në vlerë prej 30 deri në 40% pasi pozicionet filmike janë më të shtrenjta se ato teatrale;

7.2.7 Në artet pamore më tepër subvencionohet botimi i katalogëve dhe kornizimi i pikturave;

7.2.8 Hulumentimi i trashëgimisë (gërmimet arkeologjike, ruajtja, restaurimi dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë mbështetet sipas rëndësisë së objekteve që duhet hulumtuar dhe ruajtur dhe atë në faza. Vlerësimi për ndarjen e shumave bëhet sipas mendimit të ekspertëve të fushës së caktuar në lartësi deri në 40 % pasi gërmimet, restaurimet dhe konservimet janë të kushtueshme;

7.2.9. Grupet apo shoqëritë kulturore amatore që financohen prej donacioneve në rend të parë nga komuna. Puna e tyre vlerësohet duke u mbështetur në realizimin e suksesshëm të programeve të mirëfillta që kanë vlera artistike;

7.2.10 Projektet e tyre që duhet mbështetur janë: pjesëmarrja në festival në vend, mundësisht edhe jashtë vendit, koncertet e ndryshme në qytet dhe në Kosovë, pajisjet me gardërobë konvencionale dhe instrumente muzikore, ndihmat logjistike (sigurimi i sallave për

mbajtjen e koncerteve, lokalet ku do t'i përgatitin programet, automjetet për udhëtime të shkurtra, dhe ndonjë ndihmë tjetër ku komuna nuk ka shpenzime të theksuara.

7.3. Subvencionimi në fushën e rinisë:

- 7.3.1 Mbulimi i shpenzimeve të qirasë së Qendrës Kulturore të të rinjve të Hanit të Elezit në rast nevojë dhe
- 7.3.2 në projekte për fuqizimin e rinisë, organeve të saja (KVRL) etj.

7.4 Subvencionimi në fushën e sportit:

- 7.4.1 Masivizimi i sportit për të rinjë;
- 7.4.2 Ngritjen dhe renovimin e infrastrukturës sportive;
- 7.4.3 Bashkëpunim me Drejtoritë të cilat merren me punën e të rinjve dhe të rejave për masivizimin e sportit dhe ngritjes kualitative të sportistëve;
- 7.4.4 Përkrahje të qëndrueshme financiare për sportistët kulmor dhe klubet kualitative, të cilat mund të arrijnë rezultate të mira sportive;
- 7.4.5 Avancimin e organizimit në klubet sportive të femrave të cilat veprojnë në rrafshin sportiv Kosovar (masivizimi i sportit për femra);
- 7.4.6 Bashkëpunimi me Organizata të ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme sportive që kanë të bëjnë me ngritjen dhe avancimin e trajnerëve të cilët punojnë me grupmosha të ndryshme;
- 7.4.7 Kultivimin dhe avancimin i kualiteteve menaxhuese, në mënyrë që me anë të animimit të donatorëve të gjenden mjete plotësuese financiare për funksionimin profesional dhe amator të klubeve sportive;
- 7.4.8 Partneritet me të gjitha organizatat sportive për implementimin e politikave zhvillimore afat shkurte dhe afat gjate;
- 7.4.9 Punë e vazhdueshme edukative me tifozët që janë pjesë përbërëse e sportit me qëllim të evitimit të dhunës dhe me qëllim të kultivimit të vlerave fisnike të sportit.

7.5 Kriteret për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të OJQ-ve, bazohen në:

- 7.5.1 Promovimin e vullnetarizmit;
- 7.5.2 Integrimin e grupeve të marginalizuara;
- 7.5.3 Fuqizimin e organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve);
- 7.5.4 Edukimin joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim);
- 7.5.5 Punësimin e të rinjve dhe
- 7.5.6 Infrastrukturën rinore.

7.6 Kërkesa duhet të këtë provat si në vijim:

- 7.6.1 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi);
- 7.6.2 Certifikata e OJQ-së ;
- 7.6.3 Fotokopja e kartelës së xhirollogarisë dhe letër njoftimin e bartësit të kartelës;
- 7.6.4 Shënimet e personit kontaktues.

Subvencione për student

Neni 8

Ndarja e bursave për student në harmoni me rregulloren me nr.01.156-2011 për ndarjen e bursave për student.

Subvencionet për individë dhe familje

Neni 9

Në raste urgjente të fatkeqësive të ndryshme natyrore, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar për banoret e Komunës së Hanit të Elezit, sëmundjes së rëndë që kërkojnë mjekim të kushtueshëm, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara ndan ndihmë momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës.

Subvencione për familjet e dëshmorëve të rënë jashtë Republikës së Kosovës

Neni 10

Subvencionimi i familjeve të dëshmorëve të rënë jashtë teritorit të Republikës së Kosovës sipas Vendimit të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit me **Nr.01/10/2010** të datës **02.03.2010**.

Neni 11

11.1 Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për personat dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore e cila mund të jetë deri në shumën prej 1.000€.

11.2. Ndihma materiale e cekur në paragrafin 11.1 të këtij neni nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje.

11.3 Për çdo shume më të lartë nga ajo e përcaktuar në paragrafin 10.1 të këtij neni vendos Kuvendi i Komunës.

Neni 12

Subvencionet (mjetet nga fondi për transfere dhe subvencione) janë pagesa të njëanshme jo të kthyeshme, për individë dhe familje.

Neni 13

13.1 Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale:

13.1.1 Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësor të specialistit;

13.1.2 Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;

13.1.3 Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera dhe

13.1.4 Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë elementare.

Neni 14

Kërkesë për ndihme momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet qe janë banore të përhershme të Komunës së Hanit të Elezit.

Subvencionet në lëmin e bujqësisë

Neni 15

15.1. Ndarja e subvencioneve në lëmin e bujqësisë bëhet pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës për subvencionim të kësaj dege të ekonomisë.

15.2. Kryetari i komunës i propozon Kuvendit të Komunës nxjerrjen e vendimit për subvencionim në lëmin e bujqësisë duke bashkangjitur planin vjetor për subvencionim të hartuar nga drejtoria e bujqësisë së bashku me arsyeshmërinë.

Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave

Neni 16

16.1. Kompetent për shqyrtimin e kërkesave të individit apo të familjes për ndihmën momentale është komisioni i formuar nga kryetari i komunës në përbërje të zyrtarëve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky Komision ka për detyrë qe të shqyrtojë kërkesat dhe të propozon ndihme momentale.

16.2. Kërkesat e pakompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj me tutje.

16.3. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të Komisionit.

Neni 17

Shuma e ndihmës momentale për personat fizikë dhe familjar propozohet nga komisioni. Personi dhe familja e caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 18

Komisioni listën e specifikuar të propozuar për ndihme momentale ja dorëzon kryetarit të komunës i cili ka mundësi ta ndryshojë para miratimit, duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

Neni 19

Kërkesa duhet të shqyrtohet jo më larg se 30 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e komunës së Hanit të Elezit.

Neni 21

Në raste konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të rregullave financiare dhe Udhëzimit Thesarit 02- shpenzimi parave publike dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2005/08 MEF-it, klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, do të aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.

Hyrja ne fuqi

Neni 22

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Elez Han

STATUTI
I
QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Hani i Elezit, Qershor 2013

Në bazë të dispozitave të nenit 12, pika 12.2 shkronja d, të dispozitave të nenit 17, pika 17.1, shkronja k të Ligjit nr.03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.28/2008), të dispozitave të nenit 6 dhe nenit 7 të Ligjit nr.02/L -17, për shërbime sociale dhe familjare, Statutit të Komunës së Hanit të Elezit neni 6 shkronja (l), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit me date 27.06.2013 miratoi:

S T A T U T I N E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

- Me këtë Statut rregullohet emërtimi dhe selia, veprimtaria, statuti juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Qendrës, udhëheqja dhe trupat e Qendrës, zhvillimi I vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia financimi, transparenca, fshehtësia profesionale, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë në përkujdesin social dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Qendrën për Punë Sociale (në vazhdim të tekstit: QPS).
- Themelues i QPS –së është Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 2

QPS-ja ka statusin e institucionit publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku ofrohet përkujdesje dhe shërbime adekuate sociale profesionale si dhe forma të mbrojtjes në bashkëpunim me partnerët tjerë, për çdo kategori të qytetarëve në nevojë sociale e familjare konform legjislacionit në fuqi që ndërlidhet me këto shërbime.

Neni 3

- 3.1. QPS-ja disponon me mjetet dhe pasurinë të cilat i përkasin Komunës.
- 3.2. QPS-ja si institucion publik për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, është përvetësuese e fondit për financim të saj nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

II. Emërtimi dhe selia

Neni 4

- 4.1. Emërtimi i institucionit është: Qendra për Punë Sociale Hani i Elezit.
- 4.2. Shenja njohëse, emblema – logo e QPS, do të procedohet nga DSHMS-ja.
- 4.3. Emërtimi i QPS- duhet të jetë i vendosur në objekt të QPS-së dhe në objektet ku janë të vendosura njësitet e saja, në të cilin kryhet veprimtaria e shërbimeve dhe përkujdesit social, shkruar në gjuhën zyrtare në përdorim në Kosovë.
- 4.4. Për ndryshimin e emrit dhe të selisë së QPS-së vendos Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Selia e QPS-së është në Han te Elezit rruga “Dëshmorët e Kombit”.

Neni 6

- 6.1. QPS-ja ka vulën e saj që në qarkullim juridik paraqitet si: Qendra për Punë Sociale Hani i Elezit.
- 6.2. Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:
 - Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
 - Rrethi i dytë :Komuna Hani i Elezit;
 - Rrethi i tretë:Qendra për Punë Sociale- njësia;
 - Në mes të vulës është emblema.
- 6.3. Vula katrore , e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 6x2.5 cm, me përmbajtje:
 - Republika e Kosovës;
 - Komuna e Hanit i Elezit;
 - Qendra për Punë Sociale-njësia;
 - Njësia organizative, numri dhe data.
- 6.4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit dhe selinë, të shkruar në gjuhë zyrtare që janë në përdorim në Kosovë.
- 6.5. Drejtori i QPS-së vendosë për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtjen e tyre.

III. Veprimtaria e QPS-së

Neni 7

- 7.1. Veprimtaria e QPS-së përfshinë ofrimin e përkujdesit dhe mirëqenies sociale për banorët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesit dhe mirëqenies sociale në Kosovë.
- 7.2. Koncepti i përkujdesit social konsiston në atë që banorëve të komunës t’iu ofrojë dhe zbatojë përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithë përfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shoqërore: psikologji, sociologji, drejtësi, pedagogji, përmes caktimit të psikologut, sociologut , pedagogut dhe juristit , të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshëm në

sistemin e përkujdesit social dhe të mirëqenies sociale dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultant në përkujdesin dhe mirëqenien sociale.

7.3. Përkujdesi dhe mirëqenia sociale në QPS sigurohet dhe zbatohet nga punonjësit, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Kosovë.

7.4. Caktimi i punonjësve, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre do të rregullohen me akt të veçantë të cilin e miraton DSHMS-ja.

Neni 8

8.1. QPS-ja është përgjegjëse:

- Për ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit dhe në raste të caktuara edhe të ndihmës materiale, për rastet me nevojë sociale brenda territorit të komunës;
- t'iu përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
- të lejojë marrjen e përgjegjësive të drejtpërdrejta nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- të pranojë fonde vjetore nga Ministria;
- të zhvillojë aktivitetet me qëllim të sigurimit të fondeve apo ndihmave tjera materiale për organizatat joqeveritare që merren me këto veprimtari.

8.2. QPS-ja ushtron këto veprimtari:

- Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardeve të specifikuar nga Ministria;
- Ndërmerr hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të komunës;
- Përgatit planin vjetor të punës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare;
- Mban shënime e statistika, të cilat paraqesin të dhënat e aktivitetit për përkujdes social dhe familjar;
- Përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve për përkujdesin social dhe mirëqenien sociale, të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe të akteve nënligjore;
- Bashkëpunon ngushtë me DSHMS- në dhe MPMS-në, me qëllim të realizimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale;
- Ushtron edhe veprimtari të tjera të parapara me vendimet e Kuvendit të Komunës.

IV. Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi

Neni 9

9.1. QPS-ja në Han të Elezit është institucion, i cili bënë pjesë në rrjetin e institucioneve të përkujdesit dhe mirëqenies sociale.

9.2. QPS-ja kryen dhe ofron shërbime të përkujdesit dhe mirëqenies sociale për personat dhe familjet në nevojë, sipas parimit të përkujdesit dhe mirëqenies sociale, të përcaktuar në dispozitat e këtij Statuti, të ligjit për shërbimet dhe përkujdesin social, ligjit për familjen dhe të akteve nënligjore.

9.3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet, pajisjet (kapitale) të QPS-së, QPS-ja, së pari, duhet ta ketë miratimin e themeluesit.

9.4. Në rast të nënshkrimit të kontratave, nga pika 9.3., QPS-ja paraqitet si subjekt i pavarur juridik, bazuar në ligjin për prokurim publik dhe në aktet nënligjore, të cilat i nxjerr Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

9.5. Për përgjegjësitë e marra financiare, QPS-ja përgjigjet me tërë pasurinë e saj.

9.6. Komuna Hani i Elezit është përgjegjëse për obligimet e QPS-së.

9.7. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes xhirollogarisë së Komunës dhe nën llogarisë së caktuar për QPS-në.

Neni 10

Drejtori i QPS-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësim juridik dhe afarist Brenda veprimtarisë së QPS-së, duke marrë parasysh përkufizimet e këtij Statuti dhe të ligjit.

V Struktura e institucionit

Neni 11

11.1. QPS-ja, për ta realizuar funksionin e përkujdesit dhe mirëqenies sociale të banorëve, është organizuar nëpërmjet njësive-sektorëve:

1. QPS-ja, Njësia nr. 1;
2. Sektori i Asistencës Sociale
3. Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Familjare
4. Sektori i Administratës

- Personeli,
- Zyra juridike,
- Zyra për buxhet dhe financa,
- Zyra e prokurimit,
- Zyra për punë teknike.

11.2. Dispozitat më të hollësishme mbi organizimin e brendshëm të QPS-së dhe njësive të saj, përcaktohen me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

11.3. Lista e njësive në kuadër të QPS-së, do të caktohet nga DSHMS-ja pas marrjes së pëlqimit nga Këshilli i ekspertëve.

11.4. QPS-ja zbaton sistemin unik të informimit të përkujdesit dhe mirëqenies sociale, ashtu siç është paraparë me Ligjin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmë.

11.5. Shërbimin e informimit në QPS-së për shërbime sociale dhe familjare e përbëjnë:

- Sistemi i evidencave, me të cilin rregullohet baza e të dhënave dhe
- Sistemi me të cilin rregullohet dërgimi, gjegjësisht grumbullimi i të dhënave, përpunimi dhe publikimi i tyre.

11.06. QPS-ja bënë mbledhjen, evidentimin dhe vendosjen e të dhënave në bazën e të dhënave në sistemin e informimit për shërbime sociale dhe asistencë sociale në programin kompjuterik të Ministrisë , i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve të përkujdesit dhe mirëqenies sociale.

11.7. QPS-ja pas mbledhjes , evidentimit dhe vendosjes së të dhënave statistikore, është e obliguar që, përmes raporteve periodike dhe formularëve të përcaktuar nga Ministria, t'i dërgojë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe organeve të autorizuara të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

11.8. Secili punonjës në QPS-së gjatë raportimit, duhet të sigurojë fshehtësinë profesionale, duke mos cenuar të drejtat e shfrytëzuesit, përveç rasteve të rregulluara me ligj.

VI. Udhëheqja dhe trupat e QPS-së

Këshilli i ekspertëve Neni 12

QPS-ja ka Këshillin e ekspertëve, i cili e drejton aktivitetin e QPS-së, nën udhëheqjen e drejtorit.

Neni 13

Këshilli i ekspertëve përbëhet nga punonjësit e Shërbimit të përkujdesit dhe të mirëqenies sociale.

Neni 14

Këshilli i ekspertëve kryen punët , të cilat parashihen me dispozitat e nenit 7, pika 7.9 të Ligjit të shërbimeve sociale dhe familjare dhe atë:

- Punën profesionale dhe aktivitete specifike Brenda QPS-së, të përcaktuar me ligj dhe rregullore;
- Organizimin e QPS-së dhe njësive të saj;
- Vështirësitë në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara profesionale dhe ushtrimin e të drejtave dhe aktiviteteve tjera në QPS-së në rastet më të rënda individuale;
- Nevojën për arsimim shtesë profesional dhe
- Çështje të tjera të parapara me ligj dhe këtë Statut.

Neni 15

15.1. Këshilli i ekspertëve merr vendim atëherë kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

15.2. Gjatë mbledhjes së Këshillit të ekspertëve mbahet procesverbali , ekstraktin e të cilit pjesëmarrësit e shqyrtojnë dhe miratojnë në mbledhjen e radhës .

15.3. Këshilli i ekspertëve nxjerr rregulloren e punës , me të cilën rregullohen më hollësisht çështjet nga lëmi i përkujdesit dhe mirëqenies sociale, të cilat nuk janë të rregulluara me ligj, e as me këtë Statut.

Neni 16

16.1. Drejtori është përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara për QPS-së. Ai e prezanton dhe përfaqëson QPS-në.

16.2. Në mungesë të drejtorit, QPS-në e përfaqëson shefi i sektorit të DSHMS-së, me pëlqim të drejtorit të DSHMS-së

Neni 17

17.1. QPS-në e udhëheq drejtori i QPS-së.

17.2 Njësinë e QPS-së e udhëheq shefi i njësisë.

17.3. Vendimin për shpalljen e konkursit për drejtor të QPS-së e merr Kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës pas marrjes së vendimit e autorizon Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shpallë konkursin për drejtor të QPS-së, në mjetet e informimit publik.

17.4. Drejtori i QPS zgjidhet në bazë të ligjit për shërbime sociale dhe familjare

17.5. Drejtor i QPS-së mund të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e caktuara në nenin 7 të Ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare , i cili duhet të jetë: psikolog, sociolog, pedagog ose nga ndonjë lëmë tjetër që ka të bëjë me shërbimet sociale dhe familjare dhe të ketë 3 vjet përvojë pune në lëmin shoqëror.

17.6. Shefi i njësisë së QPS-së caktohet në pajtim me dispozitat që rregullojnë punësimin në Kosovë.

Neni 18

18.1. Drejtori i QPS-së është përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë dhe punën profesionale të QPS-së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe dispozitat ligjore.

18.2. Drejtori i QPS-së është përgjegjës për përkujdesjen e vazhdueshme dhe efektive të përkujdesit dhe mirëqenies sociale për të gjithë personat dhe familjet në nevojë të komunës së Hani i Elezit në pajtim me kompetencën territoriale dhe përgjigjet për detyrat në vijim:

Në pajtim me politikën e përkujdesit dhe mirëqenies sociale, Ligjin për shërbimet sociale dhe mirëqenien sociale , i propozon Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale planin e punës dhe buxhetin e QPS-ës për vitin vijues;

- Në mbikëqyrjen dhe autorizimin e drejtorit të DSHMS, zbaton buxhetin e QPS-së
- Është përgjegjës për;

-zbatimin e planit të burimeve njerëzore,

-udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QPS-së,

-zhvillimin e marrëdhënieve të mira me donatorët dhe OJQ-të

- zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QPS-së.

- vendosjen e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në objekte,

-dhënie të kontributit për zhvillimin e sistemit të informimit të përkujdesit dhe

mirëqenies sociale të QPS-së, sipas standardeve të pranuar dhe sigurimin e mbledhjes së informatave, si dhe avancimin e punës ekipore.

18.3. Programi i punës së QPS-së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të nxjerra nga MPMS.

18.4. Në programin e punës duhet të përcaktohen: masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit social dhe familjes në QPS:

- plani vjetor i punës,
- organizimi dhe udhëheqja,
- burimet njerëzore,
- plani financiar,
- raportet mujore dhe vjetore të punës dhe raportet financiare.

18.5. Drejtori i QPS-së për punën e tij i përgjigjet drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryetarit të Komunës.

Neni 19

Drejtori ka për detyrë që gjatë punës t'ia tërheq vërejtjen dhe ta pengoj Këshillin e ekspertëve lidhur me vendimet që mund të marrë, siç janë:

- a) aktet e propozuara të cilat janë në kundërshtim me ligjet relevante, respektivisht aktet e përgjithshme të QPS-së;
- b) akti i propozuar, i cili është në kundërshtim me programin e punës së QPS-së;
- c) akti i propozuar, i cili nuk i kontribuon qëllimit të paraparë.

Trupat e QPS-ës

Neni 20

Për përmbushjen e detyrave të veçanta, drejtori i QPS-së formon trupa profesionale pranë QPS-së, siç janë:

- Këshilli profesional,
- Kolegji profesional,
- Komisionin disiplinor dhe i ankesave i QPS-së,
- Komiteti për sigurinë e cilësisë në shërbime'
- Komiteti për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Këshilli profesional

Neni 21

21.1. Këshilli profesional është trup këshillëdhënëse për drejtorin e QPS-së;

21.2. Këshilli profesional përbëhet nga shefat e njësive;

21.3. Këshilli profesional nxjerr rregulloren e punës për punën e Këshillit.

Neni 22

Këshilli profesional i QPS-së kryen këto punë dhe detyra:

- Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të zbatimit të metodave dhe procedurave;

- I propozon Këshillit të ekspertëve dhe drejtorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë ;
- Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve social, si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
- Shqyrton nevojën për zhvillim profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve social për ngritje profesionale;
- Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit të ekspertëve.

Kolegjiumi profesional Neni 22

23.1. Kolegjiumi profesional themelohet me qëllim të shqyrtimit të çështjeve nga lëmi I punës profesionale të çdo njësie.

23.2. Kolegjin profesional e përbëjnë:

- Drejtori I QPS-së dhe
- Shefi I sektorit.

23.3. Kolegji profesional i kryen këto punë:

- Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në sektor dhe njësi, merr qëndrim dhe jep propozim lidhur me zgjidhjen e këtyre çështjeve;
- Shqyrton dhe përmes shefit të Sektorit , I propozon Këshillit të ekspertëve nevojën dhe arsyeshmërinë profesionale të zbatimit të metodave të reja;
- I propozon Këshillit të ekspertëve dhe drejtorit, përmes shefit të Sektorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

Organizimi sindikal Neni 24

24.1. Në QPS-së mund të organizohet Organizata sindikale, ku punëtorët, me anëtarësimin e tyre vullnetar, mund t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës dhe me ligj.

24.2. Në rast greve të punëtorëve, në QPS-së duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve.

VII. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Neni 25

25.1. Në kuadër të QPS-së ndërmerren masat për zhvillimin profesional për të gjithë punëtorët social, bazuar në dispozitat e Ligjit për shërbime sociale dhe të familjes dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmë.

25.2. Financimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punëtorëve bëhet nga buxheti I QPS-së dhe burimet në dispozicion.

VIII. Mbikëqyrja e QPS-së.

Neni 26

26.1. QPS-ja i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale , që sigurohet përmes organeve të autorizuara në bazë të këtij Statuti dhe dispozitave tjera ligjore.

26.2. Mbikëqyrjen në QPS-së e bënë Këshilli mbikëqyrës i institucionit.

26.3. Formimi, përbërja dhe funksionimi i Këshillit mbikëqyrës, përcaktohet me udhëzime administrative të nxjerra nga Ministria.

26.4. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e nxjerr Këshilli i ekspertëve i QPS-së.

IV. Aktet e përgjithshme

Neni 27

Aktet e përgjithshme të QPS-së janë: Statuti, rregulloret, urdhëresat dhe vendimet, përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e institucionit.

Neni 28

Këshilli I ekspertëve, me propozimin e drejtorit, nxjerr këto akte të përgjithshme të QPS-së:

- Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve;
- Rregulloren për mbrojtjen në punë;
- Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
- Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
- Rregulloren për rendin shtëpiak;
- Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme.

X. Pronësia, buxheti dhe financat

Pronësia

Neni 29

Pasurinë e QPS-së e përbëjnë të drejtat dhe të mirat material që kanë qenë të evidentuara si pronë komunale, të cilat QPS-ja ka pasur të drejtë t'i ketë në dispozicion me datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Buxheti
Neni 30

30.1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QPS-së , administrohen në mënyrë transparente , në pajtim me rregulloret mbi përdorimin e fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe me të gjitha procedurat në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

30.2. Buxheti dhe llogaritë e QPS-së duhet t'i përfshijnë të gjitha shpenzimet operative të njësisë punuese.

30.3. Prokurimi i QPS-së bëhet konform rregullave të Ligjit të prokurimit publik të Kosovës.

30.4. QPS-ja prezanton buxhetin vjetor për miratim Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

30.5. Drejtori mund të kërkojë revizion të jashtëm, që të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Financimi
Neni 31

QPS-ja shfrytëzon burimet financiare, në përputhje me Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare në Kosovë, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe burimet tjera të parapara me ligjet përkatëse.

XI. Transparenca në punë

Neni 32

Struktura, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve të përkujdesit dhe mirëqenies sociale, si dhe kryerja e veprimtarisë së QPS-së, janë publike dhe transparente ndaj personave juridik dhe fizik, përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional.

Neni 33

Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë, si dhe shikimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e përkujdesit dhe mirëqenies sociale, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit, mund t'u jep vetëm drejtori ose i punësuar i QPS-së të cilin ai e autorizon.

XII. Fshehtësia profesionale

Neni 34

Zbulimi i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim personave të paautorizuar, veprim i cili do t'i shkaktonte dëm imazhit dhe interes të QPS-së.

Neni 35

35.1. Sekret afarist konsiderohen:

- Dokumentet të cilat drejtori i vlerëson si sekret afarist;
- Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron institucionit si të tilla;
- Masat dhe mënyra e veprimit në raste të krijimit të situatave të jashtëzakonshme;
- Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko- teknike të punonjësve dhe pasurisë së institucionit dhe
- Të dhënat tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interes e institucionit dhe themeluesit të tij.

Neni 36

36.1. Mos ruajtja e sekretit afarist konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës.

36.2. Për ruajtjen e sekretit afarist drejtpërdrejt kujdeset drejtori.

XIII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 37

Aktet e përgjithshme do të nxirren në afat prej 120 ditësh nga dita e hyrjes së këtij Statuti në fuqi.

Neni 38

Ky Statut hynë në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Hanit te Elezit.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi

